

KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M Q A R K U L L U E S


Nr.22, datë 14.09.2018

Për përjashtimin nga skema dhe revokimin e certifikatës së sigurimit të depozitave të Bankës NBG Albania SH.A., të përthithur nga Banka Amerikane e Investimeve SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 28, pika 1, të nenit 30, të nenit 31, pika 6, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave” të ndryshuar, të nenit 8, pika 3 dhe nenit 9, pika 4 të Udhëzimit nr. 3241, datë 18.12.2014 “Për sigurimin e depozitave në banka” të ndryshuar, të nenit 10, pika 6 të Rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të nenit 24, pika 1 shkronja “k” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, të nenit 20, pika 1 të rregullores “Për licensimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë” të miratuar me vendimin nr.36, datë 26.05.2010, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, të nenit 220, pika 3 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar, si dhe të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 61, datë 6.9.2018 “Për dhënien e miratimit paraprak për bashkimin me përthithje të Bankës Amerikane të Investimeve SH.A. me Bankën NBG Albania SH.A.”, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Të përjashtojë nga skema e sigurimit të depozitave Bankën NBG Albania SH.A. të përthithur nga bashkimi me Bankën Amerikane të Investimeve SH.A.
2. Të revokojë certifikatën e sigurimit të depozitave të Bankës NBG Albania SH.A. Ngarkohet Banka NBG Albania SH.A., që të dorëzojë në Agjenci certifikatën e sigurimit të depozitave menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Banka Amerikane e Investimeve SH.A. që të mbajë të veçuara depozitat e siguruar të subjekteve pjesëmarrëse në këtë proces, për një periudhë tre-mujore nga hyrja në fuqi e revokimit të licencës të Bankës NBG Albania SH.A., që përkon me çregjistrimin e kësaj të fundit si shoqëri e përthithur në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
4. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare, shpallet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë, si dhe në një gazetë kombëtare.



KËSHILLI DREJTUES

5. Ngarkohen Sektori i Sigurimit dhe Kompensimit të Depozitave, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, Sektori i Financës dhe Investimeve dhe Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm të njoftojë Autoritetin Mbikëqyrës lidhur me këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me çregjistrimin nga Qendra Kombëtare e Biznesit të Bankës NBG Albania SH.A. si shoqëri e përthithur.

Martin Blushi
Sekretar

Donald Duraj
Kryetar